

IDC_BUP_02: Rezultatet përfundimtare të MC

Shënim

Si parim i përgjithshëm, nëse kjo procedurë rezervë nuk mund ta zgjidhë problemin deri në **Afatin e fundit për të iniciuar një Komitet të Incidencës (██████)**, operatorët i referohen **IDC_FAL_01**.

Rezultatet përfundimtare të MC duhet të sigurohen brenda afatit kohore të dedikuar prej ██████ minutash, dhe jo më vonë se afati ██████.

Përmbajtja

Shënim.....	1
1. Hyrja.....	3
1.1. Qëllimi.....	3
1.2. Qeverisur / Rregullohet nga:.....	3
1.4. Procedurat shoqëruese.....	3
2. Procedura.....	3
2.1. Rregullat për aplikimin e një pranimi të supozuar për Rezultatet Përfundimtare të MC	4
2.2. Pasqyrë e përgjithshme.....	5
2.3. Rastet e rrezikut - Sqarimi i procesit.....	6
3. Gjendja përfundimtare.....	11
4. Hetimi dhe raportimi i incidentit.....	11

1. Hyrja

Procesi që përfshihet në këtë procedurë rezervë është verifikimi i Rezultateve të Bashkimit të Tregut nga OST-të. Ky proces pasohet nga dërgimi i Rezultateve Përfundimtare të MC drejt Ofruesit të Shërbimit MC dhe dërgimi i Rezultateve Përfundimtare Globale nga NEMO drejt OST-ve.

Kjo procedurë rezervë përshkruan të gjitha rastet e rrezikut që lidhen me hapat e IDC të procedurës IDC_NOR_02 dhe zgjidhjet përkatëse të tyre.

1.1. Qëllimi

Si shënim i përgjithshëm, qëllimi i procedurave rezervë është sigurimi i një kornize të përbashkët ku të gjitha [REDACTED] rezervë duhet të harmonizohen në përputhje me rrethanat.

Qëllimi i kësaj procedure është t'u ofrojë të gjitha palëve përkatëse një përmbledhje të zgjidhjeve rezervë të aplikueshme në rast të problemeve gjatë fazës së bashkimit, të cilat mund të rrezikojnë disponueshmërinë e konfirmimit të Rezultateve të Bashkimit të Tregut deri në kohën e fundit për të filluar një IC.

[REDACTED] përmenden vetëm për qëllime referimi, ndërsa zgjidhjet e zakonshme rezervë shpjegohen më në detaje.

1.2. Qeverisur / Rregullohet nga:

- Marrëveshja Operacionale e Bashkimit të Tregut Brenda Ditës (IDCOA)
- Procedura NEMO - Ofruesi i Shërbimit MC

1.3. Mjetet dhe protokollet e komunikimit

- Sistemi Lokal i Tregtimit NEMO
- Sistemi i TI-së i OST-ve

1.4. Procedurat shoqëruese

Procedura normale:

- IDC_NOR_02: Rezultatet Përfundimtare të MC

Në vijimësi të procedurës normale:

- IDC_NOR_03: Rezultatet e Bashkimit të Tregut dhe Transferimi i Shkëmbimeve të Skeduluara

Procedurat tjera shoqëruese:

- IDC_FAL_01: Menaxhimi i Incidencës
- IDC_OTH_02: Komunikimet e brendshme dhe të jashtme
- IDC_FAL_02: Ndarja e Plotë

2. Procedura

Procesi i konfirmimit të Rezultateve të Bashkimit të Tregut nga OST-të përfshin:

- dërgimin e Rezultateve të Bashkimit të Tregut në Sistemin e TI-së së OST-ve,

- verifikimin e Rezultateve të Bashkimit të Tregut,
- dërgimin e Rezultateve Përfundimtare të MC në Sistemin Lokal të Tregtimit NEMO-s, dhe

Në çdo rast,

- nëse NEMO nuk mund t'i dërgojë Rezultatet e Bashkimit të Tregut në Sistemin TI të OST-ve, ose
- nëse Sistemi TI i OST-ve nuk mund të pranojë Rezultatet e Bashkimit të Tregut, ose
- nëse Sistemi TI i OST-ve nuk mund të kontrollojë Rezultatet e Bashkimit të tregut, ose
- nëse Sistemi TI i OST-ve nuk mund të dërgojë Rezultatet Përfundimtare të MC-së në Sistemin Lokal të Tregtimit së NEMO-s, ose
- nëse Sistemi Lokal i Tregtimit të NEMO-s nuk mund të pranojë Rezultatet Përfundimtare të MC,

pala/palët që identifikojnë problemin duhet të telefonojnë Palën tjetër sa më shpejt që është e mundur, për t'u siguruar se janë informuar për këtë çështje dhe për t'u siguruar që të dyja palët do të bëjnë atë që është e nevojshme për të komunikuar Rezultatet Përfundimtare të MC, si dhe të përpiqen të qëndrojnë në drejtimin e duhur për Bashkimin e Tregut.

Nëse Rezultatet Përfundimtare të MC-së të Rezultateve të Bashkimit të Tregut nuk janë marrë nga Sistemi Lokal i Tregtimit i NEMO-s brenda ■ minutave pasi Rezultatet e Bashkimit të Tregut të jenë dërguar nga Sistemi Lokal i Tregtimit i NEMO-s në Sistemin e TI të OST-ve, NEMO do të kontaktojë OST-të për të kërkuar informacione në lidhje me konfirmimin e Rezultateve të Bashkimit të Tregut.

Nëse një OST has në probleme për konfirmimin e Rezultateve të Bashkimit të Tregut ose synon të dërgojë një Rezultat negativ Përfundimtar të MC, NEMO siguron që Rezultatet e Bashkimit të Tregut nuk do të pranohen ose nuk do të konsiderohen të pranuar në IDC.

Nëse Rezultatet Përfundimtare të MC të Rezultateve të Bashkimit të Tregut nuk janë marrë ende nga Ofruesi i Shërbimit të MC brenda ■ minutave të dedikuara, dhe nëse procesi i Rezultateve Përfundimtare të MC nuk mund të kryhet, pranimi i supozuar do të zbatohet siç përshkruhet në Seksionin 2.1.

Të gjitha palët duhet të bëjnë çmos për të siguruar Bashkimin e Tregut.

Hapat dhe veprimet midis NEMO dhe Ofruesit të Shërbimit të MC janë përfshirë në këtë procedurë vetëm për arsye sqarimi dhe detajohen më tej në procedurat ndërmjet Ofruesit të Shërbimit MC - NEMO.

2.1. Rregullat për aplikimin e një pranimi të supozuar për Rezultatet Përfundimtare të MC

Pranimi i supozuar është një situatë ku pala validuese (OST) bie dakord që të vazhdojë me Rezultatet e Bashkimit të Tregut edhe nëse verifikimi nuk mund të kryhet. Zbatimi i pranimit të supozuar në procesin e Rezultateve Përfundimtare të MC-së është i mundur vetëm nëse NEMO ka vërtetuar tashmë Rezultatet e Bashkimit të Tregut dhe një

Konfirmim Global Preliminar pozitiv është i disponueshëm përpara afatit të fundit të Ndarjes së Plotë.

Gjatë procesit të Rezultateve Përfundimtare të MC është e nevojshme të zbatohet pranimi i supozuar në njërën prej situatave të mëposhtme:

- a) Sistemi i TI i OST-së ka probleme teknike për verifikimin e Rezultateve të Bashkimit të tregut;
- b) Fajlli i Konfirmimit Global Preliminar pozitiv është krijuar shumë afër afatit të Ndarjes së Plotë, dhe nuk ka kohë të mjaftueshme për të kryer procesin e Rezultateve Përfundimtare të MC.

Për të aplikuar pranimin e supozuar, duhet të ndiqet procesi i mëposhtëm:

- Një IC do të inicohet sipas IDC_FAL_01 nëse Rezultatet Përfundimtare të MC ende nuk janë pranuar nga Sistemi TI i Ofruesit të Shërbimit të MC brenda periudhës së dedikuar prej ■■■ minutash.
- NEMO do t'u kërkojë palëve validuese (OST) të bien dakord me zbatimin e procesit të supozuar të pranimit.
- Palët validuese pajtohen me zbatimin e procesit të supozuar të pranimit për interkonektorin AL-KS sa më shpejt të jetë e mundur dhe jo më vonë se Afati i fundit i Ndarjes së Plotë.
- Marrëveshja duhet të arrihet sa më shpejt që është e mundur dhe jo më vonë se Afati i fundit i Ndarjes së Plotë.
- Pasi të gjitha palët të kenë validuar Rezultatet e Bashkimit të Tregut ose të kenë rënë dakord me procesin e supozuar të pranimit, Rezultatet e Bashkimit të Tregut do të konsiderohen të qëndrueshme dhe procesi i pas-bashkimit mund të fillojë.

2.2. Pasqyrë e përgjithshme

Tabela më poshtë liston të gjitha rastet e rrezikut të lidhura me IDC që janë identifikuar në procedurën e ndërlidhur Normale IDC_NOR_02 dhe tregon se cilat veprime duhet të ndërmerren, si në nivel lokal ashtu edhe në atë të IDC.

Tabela 2 – Rastet e rrezikut të ndërlidhura me procesin e Rezultateve Përfundimtare të MC-së.

Rasti i rrezikut	Procesi	Segmenti i Tregut	Koha e synuar (TT/TTFR)	Afati e fundit për të inicuar IC (LTIC)	Afati i fundit i Ndarjes së Plotë (FDD)	PROBLEMI
1	Sistemi Lokal i Tregtimit i NEMO-s nuk mund t'i dërgojë rezultatet e Bashkimit të Tregut tek OST-të	CRIDA-1	■■■	■■■	■■■	IDC_FAL_01 IDC_FAL_02
		CRIDA-2	■■■	■■■	■■■	IDC_FAL_01 IDC_FAL_02
		CRIDA-3	■■■■■	■■■■■	■■■■■	IDC_FAL_01 IDC_FAL_02
2	Sistemi i IT i OST-së nuk mund të pranojë Rezultatet e Bashkimit të Tregut.	CRIDA-1	■■■	■■■	■■■	IDC_FAL_01 IDC_FAL_02
		CRIDA-2	■■■	■■■	■■■	IDC_FAL_01 IDC_FAL_02
		CRIDA-3	■■■■■	■■■■■	■■■■■	IDC_FAL_01 IDC_FAL_02

3	Sistemi i IT i OST-së nuk arrin të kryejë verifikimin e Rezultateve të Bashkimit të Tregut (dështim teknik).	CRIDA-1	■	■	■	IDC_FAL_01 IDC_FAL_02
		CRIDA-2	■	■	■	IDC_FAL_01 IDC_FAL_02
		CRIDA-3	■	■	■	IDC_FAL_01 IDC_FAL_02
4	Sistemi i IT i OST-së dështon në gjenerimin e Rezultateve Përfundimtare të MC-së.	CRIDA-1	■	■	■	IDC_FAL_01 IDC_FAL_02
		CRIDA-2	■	■	■	IDC_FAL_01 IDC_FAL_02
		CRIDA-3	■	■	■	IDC_FAL_01 IDC_FAL_02
5	Sistemi i IT i OST-së nuk mund të dërgojë Rezultatet Përfundimtare të MC në kohën e duhur pa kompromentuar kohën fikse për t'i ofruar Ofruesit të Shërbimit të MC Rezultatet Përfundimtare të MC.	CRIDA-1	■	■	■	IDC_FAL_01 IDC_FAL_02
		CRIDA-2	■	■	■	IDC_FAL_01 IDC_FAL_02
		CRIDA-3	■	■	■	IDC_FAL_01 IDC_FAL_02
6	Sistemi Lokal i Tregtimit i NEMO-s nuk mund të pranojë Rezultatet Përfundimtare të MC-së.	CRIDA-1	■	■	■	IDC_FAL_01 IDC_FAL_02
		CRIDA-2	■	■	■	IDC_FAL_01 IDC_FAL_02
		CRIDA-3	■	■	■	IDC_FAL_01 IDC_FAL_02
7	Sistemi Lokal i Tregtimit i NEMO-s pranon konfirmim negativ nga Sistemi i IT i OST-ve	CRIDA-1	■	■	■	IDC_FAL_01 IDC_FAL_02
		CRIDA-2	■	■	■	IDC_FAL_01 IDC_FAL_02
		CRIDA-3	■	■	■	IDC_FAL_01 IDC_FAL_02
8	Rezultatet përfundimtare globale pozitive nuk mund të gjenerohen nga Sistemi i IT i Ofruesit të Shërbimit të MC	CRIDA-1	■	■	■	IDC_FAL_01 IDC_FAL_02
		CRIDA-2	■	■	■	IDC_FAL_01 IDC_FAL_02
		CRIDA-3	■	■	■	IDC_FAL_01 IDC_FAL_02
9	Konfirmimi pozitiv Preliminar Global është pranuar shumë vonë për të mundësuar përfundimin e procesit të Rezultateve Përfundimtare të MC (kohë e pamjaftueshme për të validuar)	CRIDA-1	■	■	■	IDC_FAL_01 IDC_FAL_02
		CRIDA-2	■	■	■	IDC_FAL_01 IDC_FAL_02
		CRIDA-3	■	■	■	IDC_FAL_01 IDC_FAL_02
10	Moduli i verifikimit të bashkimit i NEMO-s nuk mund të dërgojë Rezultatet Përfundimtare Globale.	CRIDA-1	■	■	■	IDC_FAL_01 IDC_FAL_02
		CRIDA-2	■	■	■	IDC_FAL_01 IDC_FAL_02
		CRIDA-3	■	■	■	IDC_FAL_01 IDC_FAL_02
11	Sistemi i IT i OST-së nuk mund të pranojë Rezultatet Përfundimtare Globale	CRIDA-1	■	■	■	IDC_FAL_01 IDC_FAL_02
		CRIDA-2	■	■	■	IDC_FAL_01 IDC_FAL_02
		CRIDA-3	■	■	■	IDC_FAL_01 IDC_FAL_02

2.3. Rastet e rrezikut - Sqarimi i procesit

Rasti 1: Sistemi Lokal i Tregtimit i NEMO-s nuk mund t'i dërgojë Rezultatet e Bashkimit të Tregut të OST-të

Pasi të jenë të disponueshme Rezultatet Paraprake të Bashkimit të Tregut, Sistemi Lokal i Tregtimit i NEMO-s i dërgon ato automatikisht në Sistemin e TI të OST-ve për verifikim në kohën e publikimit.

Nëse Sistemi Lokal i Tregtimit i NEMO-s nuk është në gjendje të dërgojë Rezultatet e Bashkimit të Tregut përpara Kohës së Synuar, veprimet e mëposhtme duhet të kryhen në mënyrë të njëpasnjëshme:

- NEMO kontakton me telefon operatorin përkatës të Sistemit TI të OST-ve për t'i informuar ata për këtë çështje;

- b) NEMO kontakton me telefon me Ofruesin e Shërbimit të MC për t'i informuar rreth çështjes dhe siguron që Rezultatet e Bashkimit të Tregut nuk do të pranohen ose nuk do të konsiderohen të pranuar në IDC;
- c) NEMO dërgon Rezultatet e Bashkimit të Tregut te OST-të përkatëse në mënyrën rezervë, sipas [REDACTED].

Nëse hapi b) nuk është kryer dhe nëse Ofruesi i Shërbimit të MC nuk është informuar brenda [REDACTED] minutave të dedikuara për Rezultatet Përfundimtare të MC, do të iniciohet një IC menjëherë sipas IDC_FAL_01.

Në rast se Rezultatet e Bashkimit të Tregut konfirmohen gjatë IC, do të aplikohet pranimi i supozuar. Në rast se Rezultatet e Bashkimit të Tregut refuzohen gjatë IC, atëherë do të bëhet një hetim sipas IDC_FAL_01.

Rasti 2: Sistemi TI i OST-ve nuk mund të marrë Rezultatet e Bashkimit të Tregut

Pasi Sistemi Lokal i Tregtimit i NEMO-s të ketë dërguar Rezultatet e Bashkimit të Tregut, Sistemi TI i OST-ve i merr ato automatikisht.

Nëse një nga Sistemet e TI të OST-ve nuk merr Rezultatet e Bashkimit të Tregut përpara Kohës së Synuar, veprimet e mëposhtme duhet të kryhen në mënyrë të njëpasnjëshme:

- a) OST-ja përkatëse informon NEMO-në për çështjen përmes telefonit. Nëse NEMO nuk është informuar pas [REDACTED] minutash, ata do të kontaktojnë OST-në përkatëse;
- b) NEMO kontakton me telefon Ofruesin e Shërbimit të MC për të informuar në lidhje me çështjen dhe siguron që Rezultatet e Bashkimit të Tregut nuk do të pranohen ose nuk do të konsiderohen të pranuar në IDC;
- c) NEMO ridërgon Rezultatet e Bashkimit të Tregut dhe nëse pranimi është ende i pasuksesshëm, Rezultatet e Bashkimit të Tregut duhet të dërgohen në mënyrën rezervë;
- d) OST-ja përkatëse merr Rezultatet e Bashkimit të Tregut nga NEMO në mënyrën rezervë.

Nëse hapi b) nuk është kryer dhe nëse Ofruesi i Shërbimit të MC nuk është informuar brenda [REDACTED] minutave të dedikuara për Rezultatet Përfundimtare të MC, do të iniciohet menjëherë një IC nga NEMO.

Në rast se Rezultatet e Bashkimit të Tregut konfirmohen gjatë IC, do të aplikohet pranimi i supozuar. Në rast se Rezultatet e Bashkimit të Tregut refuzohen gjatë IC, atëherë do të bëhet një hetim sipas IDC_FAL_01.

Rasti 3: Sistemi i TI i OST-ve nuk arrin të kryejë verifikimin e Rezultateve të Bashkimit të Tregut (problem teknik)

Pasi Sistemi i TI i OST-ve të ketë marrë Rezultatet e Bashkimit të Tregut, procesi i verifikimit fillon automatikisht.

Nëse Sistemi i TI i OST-ve nuk mund të kryejë konfirmimin e Rezultateve të Bashkimit të Tregut sipas Kohës së Synuar, veprimet e mëposhtme duhet të kryhen në mënyrë të njëpasnjëshme:

- a) OST-ja përkatëse informon NEMO-n për çështjen përmes telefonit. Nëse NEMO nuk është informuar pas ■ minutash, ata do të kontaktojnë OST-në përkatëse;
- b) OST-ja përkatëse informon NEMO nëse Rezultatet e Bashkimit të Tregut konsiderohen të konfirmuara ose jo pasi ato nuk mund të kryejnë dhe gjenerojnë Rezultatet Përfundimtare të MC-së;
- c) NEMO informon ofruesin e shërbimit të MC se pranimi i supozuar duhet të kryhet ose, nëse ka kohë të mjaftueshme, NEMO dërgon Rezultatet Përfundimtare të MC në emër të OST-së përkatëse në mënyrën rezervë sipas Procedurës të NEMO - Ofruesit të Shërbimit MC

Nëse hapi c) nuk është kryer dhe nëse Ofruesi i Shërbimit të MC nuk është informuar brenda ■ minutave të dedikuara për Rezultatet Përfundimtare të MC, një IC do të iniciohet menjëherë nga NEMO. Rezultatet e Bashkimit të Tregut konfirmohen gjatë IC dhe pranimi i supozuar do të aplikohet sipas procesit të përshkruar në seksionin 2.1.

Rasti 4: Sistemi i TI i OST nuk mund të gjenerojë Rezultatet Përfundimtare të MC

Pasi sistemi i TI i OST-ve të ketë verifikuar Rezultatet e Bashkimit të Tregut, ai gjeneron një Rezultat pozitiv ose negativ Përfundimtar të MC.

Nëse Sistemi i TI i OST-ve nuk mund të gjenerojë Rezultate pozitive ose negative Përfundimtare të MC ne Kohën e Synuar, duhet të kryhen veprimet e mëposhtme:

- a) OST-ja përkatëse informon NEMO për çështjen përmes telefonit. Nëse NEMO nuk është informuar pas ■ minutash, ata do të kontaktojnë OST-në përkatëse;

Brenda ■ minutave duhet të kryhen veprimet e mëposhtme:

- b) OST-ja përkatëse informon NEMO nëse Rezultatet Përfundimtare të MC janë pozitive apo negative. Nëse Rezultatet Përfundimtare të MC janë negative, arsyeja e refuzimit duhet të tregohet qartë.
 - b.1) Nëse Rezultatet Përfundimtare të MC janë pozitive, NEMO informon Ofruesin e Shërbimit të MC se pranimi i supozuar duhet të kryhet.
 - b.2) Nëse Rezultatet Përfundimtare të MC janë negative, NEMO gjeneron një Rezultat negativ Përfundimtar MC në emër të OST, ia dërgon atë Ofruesit të Shërbimit MC dhe një IC do të iniciohet.

Nëse hapi b) nuk është kryer brenda ■ minutave të dedikuara, do të iniciohet një IC dhe do të aplikohet pranimi i supozuar.

Rasti 5: Sistemi i TI i OST nuk mund të dërgojë Rezultatet Përfundimtare të MC në kohën e duhur pa kompromentuar kohën e fiksuar për ofrimin e Rezultateve Përfundimtare të MC tek Ofruesi i Shërbimit të MC

Nëse Sistemi i TI i OST-ve ka kryer verifikimin e Rezultateve të Bashkimit të Tregut, por nuk mund të dërgojnë Rezultatet përfundimtare të MC gjatë ■ minutave të dedikuara për procesin e Rezultateve Përfundimtare të MC, veprimet e mëposhtme duhet të kryhen në mënyrë të njëpasnjëshme:

- a) OST-ja përkatëse informon NEMO për çështjen përmes telefonit. Nëse NEMO nuk është informuar pas ■ minutash, ai do të kontaktojë OST-në përkatëse;
- b) OST-ja përkatëse informon NEMO se Rezultatet e Bashkimit të Tregut konsiderohen si:
 - b.1) Të konfirmuara;
 - b.2) Të refuzuara (duke treguar qartë arsyen/et e refuzimit).
- c) OST-ja përkatëse dërgon Rezultatet Përfundimtare të MC në mënyrën rezervë të NEMO, sipas ■.
- d) Sipas statusit të Rezultateve të Bashkimit të Tregut, NEMO duhet të kryejë veprimet e mëposhtme:
 - d.1) Nëse konfirmohen Rezultatet e Bashkimit të Tregut, NEMO dërgon Rezultatet Përfundimtare të MC në mënyrën rezervë ose, nëse nuk ka kohë të mjaftueshme, Ofruesi i Shërbimit MC informohet se pranimi i supozuar duhet të kryhet;
 - d.2) Nëse Rezultatet e Bashkimit të Tregut refuzohen, NEMO siguron që Rezultatet e Bashkimit të Tregut nuk do të pranohen ose nuk do të konsiderohen të pranuar në IDC dhe dërgon Rezultatet Përfundimtare të MC që përmbajnë arsyet e refuzimit në mënyrën rezervë.

Nëse Rezultatet e Bashkimit të Tregut janë refuzuar nga OST-të, NEMO do të iniciojë thirrjen e Komitetit të Incidencës (shih IDC_FAL_01) dhe do të fillojë përgatitjen për Ndarjen e plotë (shih IDC_FAL_02).

Nëse hapi d) nuk është kryer dhe nëse ofruesi i Shërbimit MC nuk është informuar brenda ■ minutave të dedikuara për Rezultatet Përfundimtare të MC, një IC do të aktivizohet menjëherë nga NEMO. Në rast se Rezultatet e Bashkimit të Tregut konfirmohen, pranimi i supozuar do të zbatohet gjatë IC. Në rast se Rezultatet e Bashkimit të Tregut refuzohen, një hetim do të bëhet sipas IDC_FAL_01.

Rasti 6: Sistemi Lokal i Tregtimit i NEMO nuk mund të marrë Rezultatet Përfundimtare të MC

Nëse Sistemi Lokal i Tregtimit i NEMO nuk mund të marrë Rezultatet Përfundimtare të MC të Rezultateve të Bashkimit të Tregut për shkak të problemeve teknike pas ■ minutave të para të procesit të Rezultateve Përfundimtare të MC, duhet të kryhen veprimet e mëposhtme:

- a) NEMO informon OST-në përkatës për çështjen përmes telefonit;
- b) OST-ja përkatëse dërgon Rezultatet Përfundimtare të MC në mënyrën rezervë, sipas ■.
- c) NEMO dërgon Rezultatet përfundimtare të MC në mënyrën rezervë te Ofruesi i Shërbimit MC.
- d) Ofruesi i shërbimit MC ngarkon manualisht Rezultatet Përfundimtare të MC në sistemin e tij.

Nëse hapi c) nuk është kryer brenda ■ minutave, një IC do të aktivizohet menjëherë nga NEMO. Në rast se Rezultatet e Bashkimit të Tregut konfirmohen, pranimi i supozuar do

të zbatohet gjatë IC. Në rast se Rezultatet e Bashkimit të Tregut refuzohen, një hetim do të bëhet sipas IDC_FAL_01.

Rasti 7: Sistemi Lokal i Tregtimit NEMO merr një Rezultat negativ Përfundimtar MC nga OST-të

Nëse NEMO merr një rezultat negativ përfundimtar MC të Rezultateve të Bashkimit të Tregut nga OST-të, NEMO duhet të dërgojë Rezultatet Përfundimtare të MC që përmbajnë arsyen e refuzimit.

Nëse Rezultatet e Bashkimit të Tregut janë refuzuar përmes një skedari ose një telefonate brenda ■ minutave, NEMO do të inicojë Komitetin e Incidencës sipas IDC_FAL_01 dhe do të fillojë përgatitjen për Ndarjen e plotë (shih IDC_FAL_02).

Nëse refuzimi nuk është dërguar dhe Ofruesi i Shërbimit i MC nuk është informuar gjatë ■ minutave të dedikuara për Rezultatet Përfundimtare të MC, NEMO do të inicojë thirrjen e Komitetit të Incidencës.

Nëse pranohet një Rezultat negativ Përfundimtar i MC nga ndonjë palë validuese, do të gjenerohen Rezultate negative Globale Përfundimtare dhe do t'u dërgohen automatikisht të gjitha entiteteve validuese, por Ndarja e plotë nuk mund të deklarohet më.

Rasti 8: Rezultatet Përfundimtare pozitive Globale nuk mund të gjenerohen nga Ofruesi i Shërbimit të MC

Nëse sistemi i TI i Ofruesit të Shërbimit të MC nuk mund të gjenerojë një fajll të Rezultateve Pozitive Përfundimtare Globale pasi të ketë marrë Rezultatet Përfundimtare të MC nga NEMO, do të inicohet një IC.

Rrjedhimisht, Ofruesi i Shërbimit MC do të dërgojë mesazhin e brendshëm *ALPEX_InC_06* me qëllim që të konfirmojë që Rezultatet konsiderohen si përfundimtare nga të gjitha palët dhe se proceset e pas-bashkimit mund të fillojnë.

Rasti 9: Konfirmimi pozitiv Preliminar Global i marrë shumë vonë për të lejuar përfundimin e procesit të Rezultateve Përfundimtare të MC (kohë e pamjaftueshme për të validuar)

Ky rast përshkruan situatën kur Rezultatet e Bashkimit të Tregut janë pranuar nga NEMO përmes një Rezultati Përfundimtar Global pozitiv, por ka mbetur kohë e pamjaftueshme për të filluar dhe/ose përfunduar procesin e Rezultateve Përfundimtare të MC nga OST-të, deri në afatin ■■■, afati i fundit i Ndarjes së Plotë.

Më së voni në afatin ■■■, NEMO do të informojë OST-të, në mënyrë shumë të qartë në IC se është gjeneruar Konfirmimi Preliminar Global pozitiv dhe se pranimi i supozuar mund të zbatohet sipas procesit të përshkruar në seksionin 2.1.

Për t'u siguruar që të gjitha sistemet mund të vazhdojnë procesin, do të krijohen Rezultate pozitive globale përfundimtare nga Ofruesi i Shërbimit të MC dhe do t'u dërgohen të gjitha subjekteve validuese. Në rast se këto Rezultate Përfundimtare Globale pozitive nuk mund t'u dërgohen të gjitha entiteteve validuese, në vend të kësaj do të dërgohet mesazhi *ALPEX_InC_05*.

Rasti 10: Sistemi Lokal i Tregimit i NEMO nuk mund të dërgojë Rezultatet Përfundimtare Globale

Nëse Sistemi Lokal i Tregimit i NEMO nuk mund të dërgojë Rezultatet Përfundimtare Globale të Rezultateve të Bashkimit të Tregut të marra nga Ofruesi i Shërbimit të MC për shkak të problemeve teknike, veprimet e mëposhtme duhet të kryhen sipas [REDACTED]:

- a) NEMO informon OST përkatëse për çështjen përmes telefonit/emailit;
- b) NEMO dërgon Rezultatet Përfundimtare Globale në mënyrën rezervë;
- c) OST-ja përkatëse merr Rezultatet Përfundimtare Globale në mënyrën rezervë.

Rasti 11: Sistemi i TI i OST-ve nuk mund të marrë Rezultatet Përfundimtare Globale

Nëse Sistemi i TI i OST-ve nuk mund të marrë Rezultatet Përfundimtare Globale të Rezultateve të Bashkimit të Tregut për shkak të problemeve teknike, veprimet e mëposhtme duhet të kryhen sipas [REDACTED]:

- a) OST-ja përkatëse informon NEMO-në përkatëse për çështjen përmes telefonit/emailit;
- b) NEMO dërgon Rezultatet Përfundimtare Globale në mënyrën rezervë;
- c) OST-ja përkatëse merr Rezultatet Përfundimtare Globale në mënyrën rezervë.

3. Gjendja përfundimtare

Gjendja përfundimtare për të filluar procedurën tjetër normale është kur Rezultatet Përfundimtare Globale të Rezultateve të Bashkimit të Tregut janë marrë me sukses nga OST-të ose palët e tjera të autorizuar nga OST-të për t'i konfirmuar ato.

4. Hetimi dhe raportimi i incidentit

Kur procesi i bashkimit të çmimeve të përfundojë, në rast se është organizuar një Komitet i Incidencës, NEMO është përgjegjës për plotësimin e Raportit të Komitetit të Incidencës dhe shpërndarjen e tij tek të gjitha palët e Komitetit të Incidencës, siç përshkruhet në procedurën IDC_FAL_01.